



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË
DREJTORIA E PROGRAMEVE TË ZHVILLIMIT TË INDUSTRIJË
DHE ENERGJISË

Nr. 5343/prot.

Tiranë, më 17. 7. 2018

Lënda: Njoftim për fillim procedurash revokimi të lejes nr.1734, datë 15.12.2014.

SHOQËRISË "ELITE MINE" SH.P.K

Rruga "Ismail Qemali", Samos Tower, Kati 9-të, Ap. 46, Tiranë.

Për dijeni: AGJENCISË KOMBËTARE TË BURIMEVE NATYRORE
Bulevardi "Bajram Curri", Blloku "Vasil Shanto", Tiranë.

AUTORITETIT KOMBËTAR PËR SIGURINË DHE
EMERGJENCAT NË MINIERA (AKSEM), ISH RISHM
Rruga "Lord Bajron", Laprakë, Tiranë.

Shoqëria "Elite Mine" sh.p.k është zotëruese e lejes minerare të shfrytëzimit nr.1734, datë 15.12.2014, për mineral Ranorë Silicorë, në objektin "Shtyllas", Fier.

Nga struktura përgjegjëse e AKBN-së, me shkresën nr.5795, datë 27.07.2017, protokolluar në Ministrinë e Energjisë dhe Industrisë (MEI) me nr.5373, datë 01.08.2017, është propozuar revokimi i lejes minerare të shfrytëzimit nr.1734, datë 15.12.2014, për mineral Ranorë Silicorë, në objektin "Shtyllas", Fier, për arsye se nuk është kryer pagesa e rehabilitimit vjetor për vitin 2016 në shumën 29048 lekë, përcaktuar sipas pikës 5, të nenit 31, të Ligjit Nr.10304, datë 15.07.2010, "Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar.

Propozimi i Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore, për revokim, është i mbështetur në gërmën "c" dhe gërmën "ç", të pikës 1, të nenit 47 (neni që përcakton shkeljet ligjore për të cilat një leje revokohet), të Ligjit Nr.10304, datë 15.07.2010, "Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar.

Për sa më sipër, në zbatim të nenit 48, të Ligjit Nr.10304, datë 15.07.2010, "Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, ju njoftojmë fillimin e procedurave të revokimit të lejes minerare të shfrytëzimit nr.1734, datë 15.12.2014, për mineral Ranorë Silicorë, në objektin "Shtyllas", Fier, që shoqëria juaj zotëron.

Ju vëmë me dije se, pas një periudhe 30 ditore nga ky njoftim, do të merret vendimi për revokimin e lejes nr.1734, datë 15.12.2014, për mineral Ranorë Silicorë, në objektin "Shtyllas", Fier.

Në zbatim të nenit 49, të Ligjit Nr.10304, datë 15.07.2010, "Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, duhet të rehabilitoni zonën e shfrytëzimit në të cilën keni ushtruar aktivitet minerar.

Duke ju falënderuar për mirëkuptimin.

MINISTRI
DAMIAN GJIKNURI

NË MUNGESË DHE ME POROSI

ZËVENDËSMINISTRI

ENIS ALIKO

